



DETYRË PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM-PROJEKTIMIT:

**“ NDËRTIM KOPËSHT & ÇERDHE DHE QENDËR SHËNDETËSORE –
NDROQ ”**

Tiranë, Maj 2020

Bashkia Tiranë kërkon të realizojë me fondin: **1,062,586 lekë pa tvsh**, projekt-zbatimin (studim-projektim) për objektin: *“Ndërtim kopësht & çerdhe dhe qendër shëndetësore - Ndroq”*, Njësia Bashkiake Ndroq, në qytetin e Tiranës.

1. Të dhëna të përgjithshme dhe gjendja ekzistuese e objektit

Vendndodhja: Objektet ndodhet në Njësinë Administrative Ndroq, Zona 1 në Njësinë Strukturore ND/53, Tiranë. Njësia strukturore ND53 pozicionohet në pjesën perëndimore të njësisë administrative Ndroq. Ajo ndodhet në një distancë prej rreth 18 km nga qendra e qytetit në vijë ajrore.

Zona 1, e përcaktuar si zonë e përshtatshme për zhvillim banimi dhe shërbime publike në shërbim të tyre, ka një vendndodhje anës rrugës sekondare interurbane, pjesë përbërëse e rrugës kryesore interurbane Tiranë-Durrës.

Mbështetur në Planin e Detyruar Vendor Për Zonën 1 në Njësinë Strukturore Nd/53, miratuar me vendimin e Kryetarit të Bashkisë me nr. 5779/7, datë 30.03.2020, Autoriteti Kontraktor kërkon nga Konsulenti të realizojë projektimin e dy objekteve konkretisht:

Godina A e cila do të shërbejë si *qendër shëndetësore* do të jetë objekt 1 kat me sipërfaqe totale ndërtimi të parashikuar në PDyV prej **120 m²**.

Godina B që do të ndërtohet për funksionin *kopësht dhe çerdhe* do të jetë një ndërtesë 2 kat me sipërfaqe totale ndërtimi të parashikuar në PDyV prej **500 m²**.

Objekti i studim - projektimit do të jetë:

“Ndërtim kopësht & çerdhe dhe qendër shëndetësore - Ndroq” me hapësira të gjelbëruara, të shfrytëzueshme, dhe me të gjitha parametrat për zhvillimin e funksioneve përkatëset në kushte normale, duke respektuar kriteret teknike të projektimit dhe standartet në fuqi.

2. Kërkesa projektimi të përgjithshme

Në këtë zonë, gjatë hartimit të projektit, duhet ti referohemi Planit të Detyruar Vendor Për Zonën 1 në Njësinë Strukturore Nd/53. Gjithashtu, për të përcaktuar saktë kapacitetin për të gjitha shërbimet e kërkuara, duhet patur parasysh koeficienti i dendësisë së popullsisë, sipas *Rregullores së Urbanistikës* në fuqi si dhe duhen marrë në konsideratë zhvillimet urbane të pritshme dhe në perspektivë të zonës në fjalë.

A) Qendra Shëndetësore

Godina, e cila do të shërbejë si *qendër shëndetësore* do të jetë 1 katëshe, për një sipërfaqe totale prej **120 m²**.

Standardet e cilësisë së funksionimit të qendrave të kujdesit shëndetësor parësor janë të përcaktuara në “Standardet e cilësisë për akreditimin e institucioneve të Kujdesit Shëndetësor Parësor”, miratuar me urdhër Ministri Nr.298 date 14.5.2009. Si referencë janë edhe Projektet tip për ndërtimin e Qendrave shëndetësore (T1,T2) miratuar nga Ministri i Shëndetësisë; seti standart i mobilimit të qendrave shëndetësore dhe ambulancave miratuar nga Ministri i Shëndetësisë; Paketa bazë e shërbimeve në KSHP miratuar me VKM nr. 101, datë 4.2.2015; Përcaktimi i mënyrës së realizimit të Kontrollit Mjekësor Bazë për shtetasit e moshës 40-65 vjeç, miratuar me

Qendra Shëndetësore e tipit T1 Ka një sipërfaqe ndërtimi rreth 120 m² e cila është projektuar për dhënien e shërbimit shëndetësor për një komunitet me mbi 4000 banorë dhe personelin mjekësor.

Sipas standarteve duhen parashikuar:

1. dy ambiente për të shërbyer dy mjek/e familje të përgjithshëm,
2. një ambient për mjek/e për kujdesin nëna-fëmija (konsultim dhe vizita),
3. një ambient injeksioni dhe mjekimi,
4. shërbimi farmaceutik,
5. duhen parashikuar edhe ambiente të tjera dytësore (ndihmëse), si ambiente pritje, tualet, impianti për diegien e mbetjeve mjekësore, sistemi i furnizimit me ujë 24 orë (nga rrjeti dhe rezervuar ditor 500-1000 litra)etj

Infrastruktura e Qendrës Shëndetësore

Të gjithë objektet, që ofrojnë shërbimin e kujdesit parësor shëndetësor duhet të kenë 5 hapësira funksionale, me sipërfaqe standarte dhe ndriçim natyral.

- Dhomat dhe ambientet ndihmëse duhet të jenë të rregullta, të pastra dhe të pajisura me pajisje të posaçme.
- Orientimi i pacientëve brenda institucionit duhet të rregullohet përmes përdorimit të tabelave informuese, dhe hapësirës së pritjes.
- Muret e ndërtesave duhet të jenë të plota, të termoizoluara, të suvatuara dhe të lyera me bojë hidroplastike të cilësisë së lartë.
- Shkallët për ngjitje duhet të shoqërohen me rampa dhe të jenë të sigurta.
- Institucioni duhet të ketë sistem ngrohje dhe furnizim me ujë e energji elektrike.
- Ambienti i jashtëm duhet të plotësojë kushtet për pastërti dhe qëndrimin e pacientëve dhe shoqëruesve.

Territori i jashtëm

Ndërhyrjet në territorin e jashtëm kryhen për të ndërtuar një mjedis të pastër dhe të sistemuar, duke përfshirë edhe sistemin e kullimit të ujërave të shiut. Ky sistem realizohet përmes vendosjes së kunetave me zgarë metalike me gjerësi 30 cm. Për kalimin e këmbësorëve duhet të shtrohet me pllaka trotuari apo beton të stampuar një hapësirë 70 -100 cm përreth godinës, dhe me gjerësi më të madhe në hapësirën e hyrjes që shërben edhe si shesh grumbullimi. Shtresat e trotuarit janë përkatësisht pllaka granili 3-5 cm, rërë 3cm, beton 6cm dhe zhavorr 10 cm. Përveç pjesës së shtruar rëndësi të veçantë ka krijimi i një sipërfaqeje të gjelbër dhe me pemë, për vetë peshën që mbart pastërtia në këtë institucion. Këto hapësira të gjelbëruar rrethohen në njërën anë me bordura monolite 10 x30 cm dhe në anën tjetër me murin rrethues. Në sheshin e hyrjes duhen vendosur stola betoni , me veshje druri për qëndrimin e pacientëve. Rrethimi i jashtëm duhet të realizohet me mur rrethues betoni ose me blloqe, me lartësi H=1.8m, dhe kangjella metalike të lyera, me lartësi H=1.8 m. Porta kryesore e jashtme hyrëse duhet të ketë një gjerësi minimale 120 -150 cm. Për të mbajtur pastërtinë e oborrit të godinës duhet të vendosen kosha për mbeturinat në oborrin e godinës dhe sidomos në afërsi të stolave.

Ambienti i brendshëm

Hapësirat e brendshme përgjithësisht janë të shpërndara sipas skemave funksionale të secilit tip të qendrave shëndetësore. Secila prej tyre do të ketë një sipërfaqe sipas normave të miratuara të projektimit, si dhe pajisjes sipas shërbimit që ofrohet. Qendrat shëndetësore të tipit T-1 dhe T-2 duhet të pajisen me ambiente pritje, me një recepsionist dhe kompjuter për regjistrimin e vizitave dhe orientimin e pacientëve. Kjo dhomë ka karrige pritje për personat në pritje. Dhomat e mjekut

të familjes me një shtrat për vizita, duhet të kenë një standart jo më të vogël se 12 m². Në dhomat e pacientëve për çdo shtrat duhet të ketë një pajisje qendrore oksigjeni dhe vakumi të veçantë. Konsultoret e grave lehona të shtruara me fëmijët: për dhomat me një shtrat, duhet të jenë e pakta 12 m² dhe të kenë të përfshirë një tualet të brendshëm. Dhoma e mjekimit / Infeksionit krahas shtratit, duhet të jetë e pajisur me lavaman, me vend ku përgatitet mjekimi, sapun të lëngshëm, tharëse duarsh. Korridoret duhet të mundësojnë kalimin njëkohësisht të 2-3 personave.

Konstruksioni

Zakonisht konstruksioni i këtyre objekteve është me mure mbajtës prej tulle të plotë 25 cm, plintuse b/betoni dhe për këto raste duhen forcuar muratura dhe themelet ku është nevoja. Për rastet kur konstruksioni është b/a me tra- kolonë, muret e jashtëm janë më tulla të plota 25cm, ndërsa muret e brendshme 12 cm. Soletat e sipërme mund të jenë b/a monolite, ose me traveta me trashësi 30 cm, ku hapësira midis travetave (12x38) mbushet me polisterol për të siguruar termoizolim. Dritaret duhet të jenë me sipërfaqe të bollshme për kalimin e rrezeve të diellit, lehtësisht të pastrueshme, me dy kanata të hapshme për të siguruar ventilim dhe të pajisura me kangjella për arsye sigurie. Dyert e dhomave do të jenë prej druri të cilësisë së parë me përmasa 90 x 210 cm. Dyert e tualeteve do të realizohen prej duralumini me xham, me përmasa 80 x 210 cm. Vendosja e dyerve dhe plani i hapjes së tyre të realizohet i tillë që të plotësojë kushtet e daljes së shpejt në raste emergjencash. Dyshemetë duhen të jenë të shtruara me pllaka, të lëmuara dhe të rrafshëta. Ato përfshijnë: pllaka gres 30 x 30 cm, kollë ngjitëse, shtresë hidroizoluese, shtresë llustër çimento, beton me plegma 15cm, zhavorr 10 cm.

Mbulesa e sipërme

Mbulesa e sipërme e objekteve mund të realizohet me çati të pjerrët ose me tarracë të sheshtë. Për realizimin e termoizolimit të terraces, për të siguruar parametrat normale të ngrohjes pas instalimit të sistemit të ngrohjes. Skema e kullimit me pjerrësitë, numrin e ulluqeve dhe diametrat e tyre duhet të realizohen sipas normave në fuqi. Çatitë vendosen mbi nënshtresë, e cila mund të jetë: inorganike (rrasa guri, tjegulla të të gjitha llojeve, metalike), organike (druri, me kashtë, karton të bitumuar, material plastik), Duhet plotësuar disa kërkesa për mbulesën në formë çatie: e padepërtueshme t'i rezistojë agjentëve atmosferike të jetë e lehtë të largojnë sa më shpejt ujin dhe borën që bien mbi to të jetë e padjegshme të jetë sa me praktike në riparim Çatitë me tjegulla janë jetëgjatë, i rezistojnë agjentëve atmosferike. Mbulesat me tjegulla vendi realizohen me dy shtresa, ku shtresa e dyte mbulon fugat mes rreshtave të shtresës së parë. Pesha e tyre arrin 60 – 80kg/m²

Shkallët e jashtme

Sistemimi i shkallëve realizohen me beton. Shkallët shoqërohen me rampë betoni M-200 me pjerrësi të atillë, për të lejuar kalimin e personave me aftësi të kufizuara. Rampat dhe shkallët shoqërohen me kangjella metalike, për arsye sigurie.

Rifinitura

Objekti duhet të suvatohet nga brenda dhe jashtë, ndërsa xokoli duhet të suvatohet me grafiato për të siguruar hidroizolim më të mirë. Muret e brendshme do të lyhen me bojë hidromat, kurse pjesa e poshtme e mureve do të lyhet me bojë akrilike me ngjyrë të ndryshme/ose jo nga muret, ose mund të vishet me pllaka. Fasada e godinës,duhet të jete e tille që të mirëmbahet lehtësisht, janë evituar sipërfaqet e mëdha të xhamit, kurse ngjyrat e fasadës janë të lehta, në mënyrë që objekti të bëhet më atraktiv për pacientët. Në fasada duhet të shtohet veshja me kapotë termike antizjarr.

Furnizmi me ujë dhe kanalizimet

Për orientim, sasitë e ujrave të zeza që derdhen në sistemin e kanalizimeve të qyteteve të vogla, të përdorura për projektimin e rrjetit të kanalizimeve janë si më poshtë: Qmes ditë= 194 l/ditë/banorë Qmax ore= 437 l/ditë/banorë Rrjeti i shkarkimit të ujrave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkëkohore dhe në përputhje me standartet në fuqi. Gjithashtu në bashkëpunim me shoqërinë e Ujesjellës Kanalizime sh.a. do saktësohet dhe gjëndja e ujësjetllësit ekzistues të zonës si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë, duke përcaktuar edhe kapacitetin depozitues për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës. Materialet që do përdoren për rrjetin e brendshëm të ujësjetllësit do jenë tuba polietileni me densitet të lartë për ujë të pijshëm me diametër dhe aftësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse. Për nyjen e marrjes nga rrjeti i zonës do të vendosen puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. I rëndësishëm është ndërtimi i një rezervuari, të nevojshëm në raste emergjence si dhe lidhja e tij, me lavamanët dhe sanitaret (ëc) si dhe depozitat e ujit për MKZ.

Rrjeti elektrik, kompjuterik dhe telefonik

Ndërtimi i objektit duhet të përfshijë edhe instalimin elektrik, telefonik dhe rrjetin e internetit në dhomat e pritjes dhe mjekut të familjes. Ndriçimi i dhomave duhet të realizohet me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre. Duhet realizuar instalimi i rrjetit elektrik trefazor me fuqi të tillë, që të sigurojë funksionim normal të sistemit të ngrohjes. Panelet e komandimit të vendosen të rinj sipas standarteve bashkëkohore. Më parë realizohet miratimi i projektit elektrik në OSHEE, si dhe të përcaktohet edhe pikën e lidhjes me energji elektrike, nga rrjeti i fuqisë (kabina ose transformatori i zonës). Gjithashtu duhet të parashikohen edhe llampat me bateri të karikueshme, në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike, si dhe burime dytësore energjie si gjeneratorë me lëndë djegëse.

Sistemi elektrik i ndriçimit, i emergjencës dhe sigurisë.

Dhoma e transformatorit duhet të jetë e izoluar nga dhomat e tjera me mur zjarrdurues dhe nuk duhet të ketë lidhje me kalimet e emergjencës. I gjithë sistemi elektrik duhet të jetë i tillë që të stakohet në një pikë të vetme në katin e parë, e cila mund të arrihet lehtë dhe të ketë shenjat dalluese përkatëse. Skema elektrike e ndriçimit dhe e fuqisë duhet të jetë e afishuar në panelin e stakimit. Ndriçimi i emergjencës duhet të futet automatikisht në punë dhe të ketë një kohë pune të paktën 1 orë në rast se stakohet tensioni.

Sistemi i mbrojtjes atmosferike

Godina duhet të ketë sistemin e mbrojtjes atmosferike, pasi Shqipëria gjëndet në një zonë me shkarkime atmosferike te shumta. Sistemi i mbrojtjes atmosferike duhet të bëhet duke u bazuar në kushtet teknike të përcaktuara dhe në specifikimet e materialeve të ndërtimit.

Sistemi ngrohës dhe i ventilimit

Projektuesi duhet të parashikojë ndërtimin e plotë të sistemit ngrohës (ngrohje qëndrore) duke argumentuar nga ana tekniko-ekonomike zgjedhjen e mënyrës së ngrohjes, por njëkohësisht të sigurohet ventilimi i ambienteve. Në ambientet e depove, duhet parë mundësia për ndërtimin e një ambienti teknik të veçantë, ku të instalohet kaldaja, grupi i pompave, rezervuarët e ujit sanitar dhe ujit për MNZ-në . Në projekt duhet të përcaktohen, vendodhja e dhomës së kaldajës dhe karakteristikat e saj, vendodhja e rezervuarit të naftës/ambienti i depozitimit të peletit, të cilat duhet të jenë në pozicion të tillë që të furnizohet lehtë me lëndë djegëse; dimensionet dhe lloji i tubacioneve, kolektorëve, radiatorëve që do të përdoren, të gjitha llogaritjet e bëra si edhe detajet e nevojshme së bashku me specifikimet teknike përkatëse. Në dhomën e kaldajës duhet të parashikohet një dritare e hapshme ose grilë e cila do të shërbejë për ajrimin e dhomës nga gazrat e krijuara si dhe të parashikohet ventilimi mekanik (aspirator) i tij dhe instalimi i një lavamani.

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri (MNZ)

Objekti duhet të jetë i mbrojtur kundër zjarrit sipas rregullave të sigurimit teknik për MNZ sipas normave dhe standarteve europiane.

Sistemi i lajmërimit për zjarrin

Ndërtesa duhet të sistemin e brendshëm të alarmit, nëpërmjet të cilit në rast rreziku të bëhet largimi nga ndërtesa. Sinjali i alarmit duhet të transmetohet në të gjitha ambientet e brendshme dhe, të jetë i qartë dhe i kuptueshëm nga të gjithë. Sistemi i alarmit duhet të futet në punë pavarësisht nga furnizimi me energji elektrike i objektit.

Sinjalizuesit e tymit

Këto sinjalizues do të veprojnë në mënyrë që të mbajnë ekuilibrin ndërmjet dhomës së hapur dhe të mbyllur, kështu kur tymi depërton në dhomën e hapur ai do të ketë kontakt me qarkun dhe do të aktivizojë sinjalin. Të gjithë sinjalizuesit e tymit, duhet të jenë instaluar të tilla që të mund të ndërrohen me zëvendësues. Bombulat fikëse (me shkumë ose pluhur) duhet të vendosennë korridore dhe në ambientin teknik.

Nyjet sanitare

Nyjet sanitare duhet të jenë të veçanta dhe lavamanët të jenë të mjaftueshëm për numrin e shikuesve. Të sigurohet ujë i vazhdueshëm dhe i ngrohtë në lavamanë, nëpërmjet instalimit të bolierëve si dhe realizimit të rrjetit të nevojshëm hidraulik. Banjo dhe parabanjo të jenë të ajrosura, të ndriçuara dhe të ventiluara. Kur s'ka ajrim direkt duhet të pajisen me impiant ajrimi dhe 9 ventilimi. Kollonat e shkarkimit duhet të jenë të shkëputura nga kanalet e ventilimit, me ajrim në tarracë dhe shkarkimet të jenë të kontrollueshme. Tualetet duhet të kenë porta të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja dhe të përjashtohet hapja nga brenda, për raste emergjence.

B) Kopësht dhe çerdhe

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri. Projektuesi do të përdorë standardet në fuqi të projektimit të hartuara nga MASH për objektet arsimore (VKM 319 datë 12.04.2018) dhe Vkm. nr. 159, datë 01.03.2017 “Standarte për projektimin e kopshteve”.

Principi bazë i planifikimit të ndërtimit të një kopshti, është ndarja në grupe.

Çdo grup do të ketë nga 10 fëmijë minimumi deri në një maksimum 30 fëmijë. Ndarja e fëmijëve në grupe bëhet në bazë të grup moshave:

Për çerdhen:

- Grupi i parë (fëmijët më të vegjël se 1 vjeç) duhet të ketë deri në 12 fëmijë.
- Grupi i dytë, fëmijë 1- 2 vjeç (deri në 25 fëmijë).
- Grupi i tretë, fëmijë 2- 3 vjeç (deri në 25 fëmijë).

Për kopshtin:

- Grupi i parë fëmijë 3- 4 vjeç (deri në 25 fëmijë).
- Grupi i dytë fëmijë 4- 5 vjeç (deri në 25 fëmijë).
- Grupi i dytë fëmijë 5- 6 vjeç (deri në 25 fëmijë).

Kapaciteti: Kopshti duhet të akomodojë 80- 100 fëmijë, ndërsa çerdhja 50-60 fëmijë, duke marrë në konsideratë që sipërfaqja për fëmijë të motakët është 8 m²/ fëmijë dhe për latantët 7.6 m²/ fëmijë.

Në kopësht duhet të jetë grupi i çerdhes, dhoma e izolimit, dhoma e stafit, kuzhina dhe lavanteria.

Klasa e grupit duhet të ketë:

- Pranim- garderobën
- Dhomën e grupit
- Verandën dhe nyjet hidro-sanitare

Në ambientet e godinës të parashikohet dhoma e mjekut, dhoma e psikologut, si dhe dhoma për nënat e latantëve.

Mjediset e jashtme duhet të përmbajnë:

- Këndin e ujit dhe rërës
- Këndin e gjallë
- Këndin e teatrit
- Kënde lojërash të jashtme
- Mjedise të gjelbëruara dhe stola, tenda dielli etj.

Përsa i përket ndarjes funksionale dhe llojit të funksioneve, projektuesi duhet t'i referohet:

- Rregullores së funksionimit dhe administrimit të çerdheve, të QEZHES
- Rregullores Higjieno- Sanitare për ndërtimin dhe funksionimin e çerdheve, të Ministrisë së Shëndetësisë , nr. 2370, datë 09.06.1998, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
- Për sa i përket projektimit të shtesave të tjera, si anësore, ashtu edhe në kate, konsulentit duhet të zbatojë dhe t'u referohet "Standarteve e normave dhe krotoreve të projektimit për shkolla/kopshte/çerdhe të hartuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Kërkesa mbi kondicionet konstruktive dhe funksionale

Themelet

Për ndërtimin e një objekti të ri është e domosdoshme përcaktimi i vetive fizike dhe mekanike të dherave dhe masave gjeologjike që përcaktojnë terrenin ku parashikohet të ngrihet ndërtesa në fjalë.

Konstruksioni b/a dhe muratura

Ndërtimi do të jetë prej skeleti betoni dhe ndërtime muratorie brenda, të kombinuara me struktura sizmike për projektimet strukturore, me soleta betoni. Është detyrë e konsulentit të zbatojë Kushtet Teknike të Projektimit shqiptar, specifike për objektin në fjalë, si dhe standartet e miratuara, lidhur me materialet që do të përdoren.

Tarraca dhe hidroizolimi i saj

Projektuesi duhet të japë të gjitha detajet për shtresat e tarracës, vendosjen e kasetës së shkarkimit dhe ullukëve vertikalë - horizontalë. Në projektimin e ullukëve duhet të merret në konsideratë që të mos bllokohen nga faktorët e jashtëm. Në tarracë duhet të evidentohen problematikat e filtrimit të ujërave dhe izolimit dhe të parashikohet aftësia e saj mbajtëse për gjelbërimin dhe fëmijët, të cilët do e përdorin për aktivitete.

Suvatimet dhe lysterja e mureve

Objekti duhet të suvatohet nga brenda dhe nga jashtë, xokoli të suvatohet me granil.

Muret dhe tavanet do të lyhen me bojë hidromat, ndërsa ngjyra e tyre do të vendoset në bashkëpunim me stafin e shkollës.

Fasada

Fasada të jetë e tillë, që të mirëmbahet lehtë, të evidentohen sipërfaqet e mëdha të xhamit atje ku është e mundur, kurse ngjyrat e fasadës të jenë tërheqëse, në mënyrë që objekti të jetë sa më atraktiv për fëmijët. Fasadat duhet të jenë të veshura me kapotë termike antizjarr. Konsulenti duhet të përcaktojë gjithashtu vendndodhjen e tabelës me emrin e kopshtit dhe çerdhes.

Shtresat e pllakave

Për dhomat e ndjenjes dhe të gjumit, ku do të qëndrojnë fëmijët, të jenë të shtruara me parket, ndërsa ambientet e shërbimit me pllaka, të tilla që të mos krijojnë rrëshqitje. Dyshemetë e tualeteve dhe muret e tyre në një lartësi të caktuar, duhet të izoloohen dhe projektuesi duhet të japë detajin e izolimit të tyre. Çdo shtresë duhet të jetë e detajuar me specifikimet përkatëse.

Klasat e fëmijëve

Zonat e qëndrimit të fëmijëve, duhet të përfshijnë edhe zonën e pranimit, në të cilën fëmijët mund të lejnë sendet e tyre personale, tualetet përkatëse dhe ambientet e fjetjes. Tavolinat duhet të jenë minimumi 1.2 m larg njëra-tjetrës. Ambientet e pranimit duhet të kenë minimalisht këto mobilie dhe aksesore (me materiale që duhet të jenë joalergjike si dhe të padëmshme për shëndetin e fëmijëve):

- Dollape me modul (0.4 x 0.4 h= 0.5m) min 5 copë
- Dollape me varje me modul (0.3 x 0.4 h= 0.6m) min 5 copë
- Dollapë të përshtatur për përdorim nga PAK (minimum) 1 copë

Zonimi i hapësirës së qëndrimit të fëmijëve, do të bëhet npm këtyre hapësirave funksionale:

- Hapësira e ushqimit
- Hapësira e lojës
- Hapësirë didaktike
- Hapësirë teatrale

Dyert dhe dritaret

Projektuesi duhet të përcaktojë që materialet që do të përdoren të jenë të cilësisë së lartë. N.q.s janë propozuar dyer prej druri, ato duhet të jenë prej druri të fortë me mentesha të forta.

Vendosja e dyerve dhe plani i hapjes së tyre të realizohet i tillë që të plotësojë kushtet e daljes së shpejtë në raste emergjencash, sipas standarteve të vendosura nga MASH.

Dritaret të përzgjidhen të tilla që sigurojnë eficienten termike.

Ambientet sanitare

Në bashkëpunim me stafin mësimor, konsulenti duhet të parashikojë ambjente sanitare të përshtatshme për grupmoshën e fëmijëve.

Nyjet sanitare të jenë të veçanta dhe lavamanët të jenë të mjaftueshëm për numrin e nxënësve. Të sigurohet ujë i vazhdueshëm dhe i ngrohtë në lavamanë, për këtë arsye të shikohet mundësia e instalimit të boliereve, si dhe realizimi i rrjetit të nevojshëm hidraulik.

Banjat të jenë të ajrosura, të ndriçuara dhe të ventiluara. Kur s'ka ajrim direkt duhet të pajisen me impiant ajrimi dhe ventilimi. Banjat të kenë porta të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja dhe të përjashtohet hapja nga brenda, për raste emergjence.

Rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimeve

Gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhet të merren parasysh kërkesat si më poshtë:

1. Të merret në konsideratë perspektiva 10 vjeçare e rritjes së numrit të fëmijëve në këtë

zonë.

2. Të merret në konsideratë rrjeti ekzistues i kanalizimeve të zonës ku do të ndërtohet objekti, por gjithashtu konsulenti duhet të marrë në konsideratë projektin e ri të kanalizimeve për këto zona (në qoftë së oft janë përgatitur).
3. Drejtimi i zhvillimit urbanistik i zonës do të merret në Bashki.

Për orientim, sasitë e ujrave të zeza që derdhen në sistemin e kanalizimeve të qytetit të Tiranës të përdorura për projektimin e rrjetit të kanalizimeve janë si më poshtë:

$$Q_{mes\ dit} = 194 \text{ l/ditë/banorë}$$

$$Q_{max\ or} = 437 \text{ l/ditë/banorë}$$

Në përputhje me normat, konsulenti duhet të ketë parasysh numrin e fëmijëve, stafit mësimor dhe administrativ.

Rrjeti i shkarkimit të ujrave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkohore dhe në përputhje me standartet në fuqi.

Materiale plastike nuk do të përdoren në projekt si: kanal kullimi, ulluk shiu, tubacion, pjesët e brendëshme të ëC-ve, etj, përveç se në rastet kur rekomandohet nga konsulenti se është materiali më i mirë që mund të përdoret për këtë qëllim. Gjithashtu në bashkëpunim me shoqërinë e Ujesjellës-Kanalizime sh.a. do saktësohet dhe gjëndja e ujësjetllësit ekzistues të zonës si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë duke përcaktuar edhe kapacitetin depozitues për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës.

Materialet që do përdoren për rrjetin e brendshëm të ujësjetllësit do jenë tuba polietileni me densitet të lartë për ujë të pijshëm me diametër dhe aftësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse.

Për nyjen e marrjes nga rrjeti i zonës do të parashikohet puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi.

Projektuesi të parashikojë në projekt/preventivin e objektit, vlerën e furnizimit dhe vendosjes së linjës së furnizimit me ujë nga pika e marrjes së dhënë nga Ujësjetllës –Kanalizime sh.a Tiranë deri tek matësi i ujit.

Të parashikohet realizimi i depozitave të ujit, të nevojshme në raste emergjence si dhe lidhja e tyre me të paktën dy prej lavamaneve dhe sanitareve (ëc) si dhe depozitat e ujit për MKZ.

Sistemi elektrik i ndriçimit, i emergjencës dhe sigurisë

Konsulenti duhet të parashikojë ndriçimin e dhomave me ndriçues me fuqi të mjaftueshme për të garantuar një ndriçim në përputhje me normat në fuqi, dhe një numër të mjaftueshëm prizash për secilin ambient, sipas destinacionit të tyre.

Për kuzhinën, numri dhe pozicioni i ndriçuesve, i prizave dhe fuqia e tyre, do të vendoset në bashkëpunim me stafin e kopshteve. Në vendosjen e prizave, duhet të merren parasysh elementët e sigurisë si lartësia nga dyshemeja dhe lloji i prizës.

Projektuesi duhet të japë detajin e fiksimit të ndriçuesve si dhe dimensionet e vidave që duhet të përdoren.

Projektuesi duhet të parashikojë instalimin e rrjetit elektrik trefazor me fuqi të tillë që të sigurojë funksionim normal të sistemit të ngrohjes. Në rast se del e nevojshme që të ndërtohet kabinë e re elektrike, duhet të parashikojë projekt/preventivi i saj. Panelet e komandimit të vendosen të rinj sipas standarteve bashkëkohore.

Projektuesi duhet të sigurojë miratimin e projekteve elektrike në OSHEE , si dhe të përcaktojë

edhe pikën e lidhjes me energji elektrike, nga rrjeti i fuqisë (kabina ose transformatori i zonës). Projektuesi duhet të parashikojë vendosjen e matësit elektrik trefazor, lidhjen e kontratës me Zonën e Shpërndarjes Elektrike Tiranë, si dhe vlerën e përafërt të shtrimit të kabllit nga sahati deri te pika e lidhjes së miratuar, \Projekti elektrik të jetë i shoqëruar me liçensën e noteruar të inxhinierit elektrik, e cila do të shërbejë për procedurat e mëtejshme për miratimin e pikes së lidhjes me OSHEE.

Klasat e grupeve të jenë të ndriçuara mirë. Ndricimi natyral të jetë 1.5 luks, ndricimi artificial të jetë 100 luks;

I gjithë sistemi elektrik duhet të jetë i tillë që të stakohet në një pikë të vetme në katin e parë, e cila mund të arrihet lehtë dhe të ketë shenjat dalluese përkatëse. Skema elektrike e ndriçimit dhe e fuqisë duhet të jetë e afishuar në panelin e stakimit.

Ndriçimi i emergjencës duhet të futet automatikisht në punë dhe të ketë një kohë pune të paktën 1 orë në rast se stakohet tensioni.

Dhoma e transformatorit duhet të jetë e izoluar nga dhomat e tjera me mur zjarrdurues dhe nuk duhet të ketë lidhje me kalimet e emergjencës.

Sistemi ngrohës dhe i ventilimit

Projektuesi duhet të parashikojë ndërtimin e plotë të sistemit ngrohës (ngrohje qendrore) duke argumentuar nga ana tekniko-ekonomike zgjedhjen e mënyrës së ngrohjes por njëkohësisht projekti të sigurojë ventilimin e ambienteve.

Projektuesi duhet të parashikojë instalimin e rrjetit elektrik me fuqi të tillë (tre fazor) që të sigurojë funksionim normal të sistemit të ngrohjes.

Projektuesi të shikojë mundësinë për ndërtimin e një ambienti teknik të veçantë ku të instalohet kaldaja, grupi i pompave, rezervuarët e ujit sanitar dhe ujit për MNZ-në .

Në projekt duhet të jepet qartë dhe e detajuar, vendodhja e dhomës së kaldajës dhe karakteristikat e saj, vendodhja e peletit, dimensionet dhe lloji i tubacioneve, kolektorëve, radiatorëve që do të përdoren, të gjitha llogaritjet e bëra si edhe detajet e nevojshme së bashku me specifikimet teknike përkatëse për fazën e projekt zbatimit.

Në dhomën e kaldajës të parashikohet një dritare e hapshme ose grilë e cila do të shërbejë për ajrimin e dhomës nga gazrat e krijuara si dhe të parashikohet ventilimi mekanik (aspirator) i tij dhe instalimi i një lavamani.

1) Lënda djegese që duhet të përdoret duhet të jetë pelet, jo naftë, për shkak se kostoja e ngrohjes me pelet është sa gjysma e kostonë së ngrohjes me naftë.

2) Radiatorët e ngrohjes duhet të jenë prej alumini dhe jo prej çeliku. Kjo sepse alumini ka përcjellshmëri termike më të lartë dhe jetëgjatësi më të madhe (nuk shpohen nga ndryshkja, siç ndodh me çelikut).

3) Linjat dytësore të qarkullimit të cilat në projektet e deritanishme janë bërë me tuba bakri duhet të zëvendësohen me tuba multistrat. Kjo gjë sjell dy avantazhe:

a) Tubi multistrat është disa herë më i lirë se tubi i bakrit, punohet më shpejt dhe i reziston kushteve të punës.

b) Nuk krijon çift elektrokimik me kolonën e çelikut që sjell si pasojë oksidimin e shpejtë të çelikut dhe shpimin e këtyre tubave, siç ndodh me çiftin Fe-Cu.

4) Tubat, pranë kaldajës dhe deri pranë kolonave vertikale, duhet të jenë çelik manesman, ndërsa kollonat vertikale mund të bëhen çelik, ose edhe multistrat cilësor nëse çmimi i një metri tub multistrat është më i lirë se i një metri çelik i të njëjtë diametër.

5) Pozicioni i vendosjes së dhomës teknike dhe lartësia e oxhakut që parashikohet të vendoset duhet të marri në konsideratë mos ndotjen nga tymi të objektit që ndërtohet, por edhe të objekteve të tjera pranë.

Sistemi i mbrojtjes atmosferike

Godina duhet patjetër të ketë sistemin e mbrojtjes atmosferike pasi Shqipëria gjëndet në një zonë me shkarkime atmosferike te shumta.

Sistemi i mbrojtjes atmosferike duhet të bëhet duke u bazuar në kushtet teknike të përcaktuara dhe në specifikimet e materialeve të ndërtimit.

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri (MNZ)

Konsulenti duhet të paraqesë dhe projektin e mbrojtjes nga zjarri si dhe rregullat e sigurimit teknik për MNZ sipas normave dhe standarteve europiane.

Sistemi i lajmërimit për zjarrin

Në objekt të shikohet mundësia e një kabinë telefonike që të mund të përdoret në çdo moment. Numrat e telefonit të zjarrfikësit duhet të jenë të afishuar dukshëm në këtë kabinë. Ndërtesa duhet të ketë gjithashtu sistemin e brendshëm të alarmit, nëpërmjet të cilit në rast rreziku të bëhet largimi nga ndërtesa. Sinjali i alarmit duhet të transmetohet në të gjitha ambientet e brendshme dhe të jetë i qartë e i kuptueshëm nga të gjithë. Sistemi i alarmit duhet të futet në punë pavarësisht nga furnizimi me energji elektrike i objektit.

Sinjalizuesit e tymit

Këto do të veprojnë në mënyrë që të mbajnë ekuilibrin ndërmjet dhomës së hapur dhe të mbyllur, kështu kur tymi depërton në dhomën e hapur ai do të ketë kontakt me qarkun dhe do të aktivizojë sinjalin. Të gjithë sinjalizuesit e tymit, të jenë instaluar të tilla që të mund të ndërrohen me zëvendësues.

Bombulat fikëse të zjarrit

Bombulat fikëse (me shkumë ose pluhur) duhet të vendosen në korridore dhe në ambientin teknik.

Kalimet e emergjencës, shkallët, koridoret

Numri dhe gjerësia e kalimeve të emergjencës duhet të sigurojnë largimin sa më të shpejtë dhe shfrytëzimi i tyre të nxjerrë në vend të sigurt jashtë ndërtesës me një rrugë të shkurtër, të shpejtë dhe pa rrezik.

Për përcaktimin e gjerësisë dhe gjatësisë së rrugëve të emergjencës, faktori kryesor është kohëzgjatja e largimit të personave nga objekti. Koha maksimale e largimit nga objekti në sekonda për çdo dhomë, mbas dhënies së sinjalit të alarmit duhet të jepet e llogaritur nga projektuesi.

Shkallët

Për këto grupmosha, shkallët duhet të kenë gjerësi deri 100-1200 cm, dhe lartësia e basamakut 12 cm, ndërsa pjerrësia e tyre të mos jetë më shumë se 10. Shkallët të jenë me parmakë mbrojtës dhe përmasa: shkelja 30-33 cm dhe ngjitja 15 cm sipas formulës 1 hap shkallë + 2 lartësi (ballina) = $62 \div 64$ cm. Në çdo bazamak të vendosen shirita abrazive. Para fillimit dhe në përfundim të shkallës, si edhe të gjitha planet ngjitës të jenë me ngjyrë me kontrast me bazamakët për lehtësi përdorimi nga PAK me vështirësi në shikim. Shkallët duhet të jenë të paisura me parmak në të dy krahët me korimano të pozicionuara në lartësi 60 cm. dhe 90 cm. Parmaku duhet të zgjatet 30 cm në fillim dhe në fund të shkallës

Ambientet e gatimit

Muret në këto ambiente duhet të jenë të veshura me pllaka. Projektuesi duhet të parashikojë në rrjetin e instalimeve elektrike edhe mënyrën e gatimit me sobë me korent, kurse në rastin e

gatimit me sobë me gaz ai duhet të ketë parasysh elementët e sigurisë. Te kuzhina duhet të jepet në projekt, dalja e tubacionit të aspiratorit ose futja në oxhak nëse ka të tillë, si dhe të parashikohet dalje e veçantë prize për të gjitha paisjet e kuzhinës dhe të lavanderisë(aspirator, lavastoviglie, lavatriçe, frigoriferë, boilerë etj). Kuzhinat të pajisen me dedektorë nxehtësie.

Sistemimet e jashtme dhe ambientet e gjelbëruara

Projektuesi duhet t'i kushtojë një rëndësi e veçantë sistemimit të ambienceit përreth kopshtit dhe tarracës së gjelbër të shfytëzueshme. Oborri të rezultojë me rrethim transparent (kangjella, etj) dhe të garantojë të gjitha normat e sigurisë dhe standarteve për ndërtime të këtij lloji. Mundësisht të jetë parashikuar edhe një sistem citofonie i inkorporuar i cili duhet të funksionojë në të gjitha ambientet e tjera të godinës.

Ambientet e jashtme, janë ambiente që kryesisht shërbejnë për qëndrim, çlodhje, sidomos si ambiente loje të cilat janë pjesë integruese edhe e programit të edukimit të përgjithshëm për fëmijët e kësaj grupmoshe. Këto sheshe duhet të jenë gjithashtu të pajisura me tenda dhe mbulesa për mbrojtjen nga dielli. Rëndësi të veçantë ka edhe krijimi i sipërfaqeve të gjelbërta dhe me pemë.

Përpara hyrjes në objekt të parashikohet krijimi i një strehë për vend qëndrimin e karrocave.

Projektuesi duhet të japë të detajuara shtresat përkatëse dhe teknologjinë e zbatimit të tyre, dhe të kombinojë ambientet e lojes me ambientet e gjelbëruara duke parashikuar edhe realizimin e këndeve të lojrave për fëmijët e këtyre grupmoshave.

Konsulenti duhet të parashikojë dhe ndriçimin e jashtëm të objektit, në përputhje me planin urbanistik të kësaj zone dhe në përputhje me kërkesat e veçanta për rrjetin e ndriçimit të dhënë në këtë detyrë projektimi.

Për të mbajtur pastërtinë duhet të vendosen kosha për mbeturinat në oborr dhe në tarracë. T'i kushtohet kujdes i veçantë, sistemimit dhe disiplinimit të ujrave sipërfaqësore.

Sugjerohet që shpërndarja e hapësirave të bazohet në tabelën e mëposhtme:

Kopshet me ushqim në zonat urbane me lavanderi / me gjashtë grupe 3,62 m ² /fëmijë				
ADMINISTRATA		HOLLI + KORRIDORET	DHOMA (kemi gjashtë dhoma total)	
Drejtoria	15m ²	62m ²	Hapësire loje+ngrenie+ fjetje	45m ²
Infemieri	9m ²		Wc	5m ²
Psikolog	9m ²		Filter hyrje	7,5m ²
Dhoma e izolimit	6m ²		Tot 57,5 x 6 =	345m ²
Takim prinder edukatore	18m ²			
Depo	15m ²		Keshillohet jo e detyrueshme	
Lavanderi	10m ²		Hapësire gjumi me vete	1,2 m ² /f Min30m ²
Zona e shveshjes e stafit	15m ²		Hapësire mbeshtetese	0,3 m ² /f Min7,5m ²
Kuzhina	30m ²			
Wc	9m ²			
Tot	136m²	62m²	Tot	345m²

TOTALI =
136m²
62 m²
345 m²
543 m²
(Ky tip kopsht mund

te projektohet me dy kate).

3. Fazat e zbatimit

Për efekt të fondit të zbatimit, të realizimit të prishjeve (të mundshme) si dhe të efijencës së ndërhyrjes, projektuesi duhet t'i rekomandojë investitorit fazat e realizimit në kohë (ose sipas elementëve të ndryshëm) të projektit.

Projektuesi mund t'i rekomandojë Investitorit, që projekti të realizohet në disa faza ose lote, si dhe sipas elementëve të ndryshëm të tij (psh. rrjetit rrugor dhe infrastruktura/punime ndërtimi, apo mobilimi urban/furnizim, vendosje).

Lidhur me këtë fakt, projektuesi do të propozojë fazat e realizimit të projektit, ku të dhenat (si fletët e projektit, preventiva, grafiku i punimeve) për çdo fazë duhet të jenë të konceptuara ose të organizuara, që të lehtësojnë Investitorin në organizimin e zbatimit (buxhetim, prokurim, kontraktim për zbatim) të projektit me faza.

4. Standartet

4.1 Standarte në projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim, që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standareve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elementë të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për PAK (personat me aftësi të kufizuar). Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në fletë të veçanta të projektit.

4.2 Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të parashikohet dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji "Për urbanistikën", Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

5. Realizimi i projektit

Realizimi i projektit do të mbështet në fazat e VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, Neni 42, Neni 43, Faza I-VI të nenit respektiv sipas tipologjisë.

FAZA I Analiza e detyrës së projektimit

Analiza e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit (format A4); Vëzhgimi dhe mbledhja e dokumenteve fartografike për zonën në të cilën duhet ndërhyrë - (formati A3/A2).

Materiali grafik i përgatitur nga konsulenti duhet të përfshijë:

- Pozicionimi në hartat;
- Përshkrimi i situatës aktuale;
- Verifikimi i projekteve/studimeve të miratuara për zonën objekt studimi etj.

Fletët grafike do të përgatiten bazuar në vërtetimin; ato duhet të jenë lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme.

Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy (të printuar) dhe 1 cd në format soft copy (cad,exel,ëord).

FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit).

Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant-propozime, ku për secilin variant do dorëzohet:

1. Analiza e e bazës materiale dhe e parimeve;
2. Vlerësimi i ndërtimeve ekzistuese (evidentimi i objekteve që prishen/ruhen)
3. Vizatimet teknike :planimetri të përgjithshme, planvendosje, fasadat në 2D
4. Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara);
5. Preventiv paraprak.

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik, që do të përzgjidhet nga Këshilli Teknik, do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare.

(Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake e specifikimet përkatëse duke përfshirë dhe kostot e shpronësimeve, nëse ka, për secilin variant).

Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy (të printuar) dhe 1 cd në format soft copy (cad,exel,ëord).

FAZA III Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integritit)

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Në këtë fazë konsulenti duhet të përgatisë projekt idenë përfundimtare të ndërhyrjeve, pas miratimit në Këshill Teknik të variantit socio-ekonomik dhe teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë-paraprake, e cila duhet të përmbajë:

- a. Raport teknik;
- b. Preventivin e punimeve sipas formatit të miratuar nga Bashkia Tiranë, referuar VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të

- ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”;
- c. Analizat teknike të çmimeve, për zërat, që nuk ndodhen në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”;
 - d. Vizatimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara me detajet përkatëse;
 - e. Specifikimet teknike për zërat e punimeve, që do të kryhen;
 - f. Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
 - g. Rilevimi;
 - h. Studimi gjeologjik.

Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy (të printuar) dhe 1 cd në format soft copy (cad,excel,ëord).

Pranë Drejtorive përkatëse të Bashkisë dhe institucioneve në varësi, kryhet aplikimi, nga ana e operatorit ekonomik të kontraktuar për hartimin e studim-projektimit, për vendosjen në dispozicion të informacionit në lidhje me azhurnimet inxhinierike, statusin juridik të pronës etj.

FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, si i cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Është përgjigjësi e projektuesit aplikimi për leje ndërtimi nëpërmjet sistemit të aplikimit të lejeve on-line.

Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrimit të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Tiranë.

Materialet dorëzohen në 2 kopje cd, projekti dhe dokumentacioni shoqëruar me vulë elektronike.

FAZA V: Projekti zbatimit: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

Dosja e plotë e projektit të zbatimit për objektin: “Ndërtim kopësht & çerdhe dhe qendër shëndetësore - Ndroq” duhet të përmbajë:

- a. Raporti teknik;

Raporti përfundimtar teknik përfshin të gjitha informacionet në lidhje me projektin, duke shpjeguar arsyet në të cilat u bazua skema e detajuar e projektit. Ai përshkruan analizën e bërë nga projektuesi për situatën dhe projektin e propozuar. Raporti të sigurojë të dhëna të sakta, bazuar në testet / vlerësimet ekzistuese, llogaritjet e bëra, llogaritja e efencences energjitike, ndriçimit, etj., masat inxhinierike që parashikohen të merren, etj. Në raportin teknik do të përfshihet raport arkitektonik, raport strukturor, elektrik, hidro, kondicionimi etj., si dhe studimet mbështetëse (vlerësimet topografike, gjeologjik dhe materiale, raport hidrologjik dhe hidraulik, etj.).

- b. Projektin arkitektonik: Relacion arkitektonik i objektit, Fasadat, Planimetritë ekzistuese dhe të reja të objektit, Prerjet e godinës, Plan mobilimin e ambienteve, Plani i mbulesës, etj;

- c. Projektin e zbatimit/konstruksionin të objektit: Plani i strukturave dhe detajet, Plani i themeleve, etj.
- d. Projekt Zbatimin e instalimeve hidrosanitare, të kanalizimeve
- e. Projekt Zbatimin e instalimeve elektrike, të shoqëruara me licencën e noteruar të projektuesit
- f. Projekt Zbatimin e instalimit të sistemit të ngrohjes, të mbrojtjes kundër zjarrit të strukturës të miratuar nga Drejtoria e Zjarrit dhe Shpëtimit
- g. Projektin e sistemit dhe të gjelbërimit të oborrit,
- h. Rilevimin topografik,
- i. Studimin gjeologo-inxhinierik,
- j. Studimi sizmologjik,
- k. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujërave të shiut;
- l. Rekomandime për materialet e ndërtimit që do të përdoren
- m. Relacionin gjeologjik,
- n. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza;
- o. Projektin e zbatimit të rrjetit të ujësjellësit, përfshirë dhe detajet e pushtave të pajisjeve dhe rakorderive të nyjeve, etj;
- p. Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;

Kontraktuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilën material që do të përdoret. Për secilën punë të përfshirë në preventiv, duhet të bëhet analiza sipas kësaj skeme:

- Përshkrimi i detajuar i procesit të punës;
 - Metoda e vendosjes;
 - Cilësia e kërkuar;
 - Format e miratuara;
 - Ngjyra e rekomanduar;
 - Skica, vizatime ose foto
- q. Preventivin e punimeve mbështetur në manualin teknike të çmimeve në fuqi;
 - r. Analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve që nuk janë në manual;
 - s. Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
 - t. Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikun e punimeve;
 - u. Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);
 - v. Liçensë të firmës projektuese, liçensë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrimit tregtar.
 - w. Deklaratat e përgjegjësisë profesionale të stafit pjesëmarrës në realizimin e studimit-projektimit

Materialet dorëzohen në 5 kopje format hard copy (të printuar) dhe 5 cd (4 cd në format soft copy cad,excel,ëord etj dhe 1 cd në format pdf).

FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM NR. 629, datët. 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizimin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të hartohet sipas formatit/modelit standart të rekomanduar nga Bashkia Tiranë.

6. Rekomandime për projektuesin

- a. Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën. Projektuesi duhet të hartojë, përveç projektit përfundimtar dhe një projekt teknik i cili duhet të analizojë rast pas rasti të gjitha prishjet e mundshme për të realizuar me faza këte investim.
- b. Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake, që disponohen nga Bashkia e Tiranës, seksioni i Urbanistikës dhe nga Kadastra. Në hartimin e projektit duhet të merren në konsideratë edhe standarte të ndryshme, që ka nxjerrë Bashkia e Tiranës.
- c. Grupi i projektimit përveç objektit të ndërtimit, duhet të trajtojë dhe hapësirat , si zonat e gjelbërta, terrenet sportive, këndet e lojërave për fëmijë etj.
- d. Në projekt të parashikohet mundësia e krijimit të faciliteteteve për PAK

7. Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimalisht fletët si mëposhtë:

- a. Horografia
- b. Topografinë e gjendjes ekzistuese, në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjendjen e sotme (me leje dhe pa leje) në Shk. 1:500 ose 1:1000;
- c. Planvendosjen e objekteve në Shk 1:100
- d. Planimetria e përgjithshme e objekteve në Shk. 1:200; 1:500
- e. Fasadat në 2D dhe 3D Shk.1:100
- f. Prerjet e godinave (në të dy drejtimet) Shk.1:100
- g. Projekti për konstruksionin e godinave Shk.1:100;
- h. Projekti për sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit Shk.1:100
- i. Projekti për sistemin e ngrohjes Shk.1:100
- j. Projekti për ndriçimin e zgjedhur të brendshëm dhe të jashtëm . Shk.1:100;
- k. Plan qarkullimi i personave me aftësi të kufizuara
- l. Planvendosja e objekteve në shkallën 1 : 1000 format A3;
- m. Të gjitha fletët e vizatimeve duhet të jenë të detajuara me elementët përkatës, si dhe legjendat përkatëse.

8. Raportimi dhe dorëzimi final

Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar njëherë të gjitha fazat e mësipërme dhe në rast se preventivi i projekt-zbatimit do të ketë vlerë të barabartë apo më të madhe se 100,000,000 lekë më t.v.sh., projekti do t'i nënshtrohet opinionit teknik të Institutit të Ndërtimit, sipas afateve përkatëse. (të miratuara përkatësisht nga Këshilli Teknik i Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike).

Ne afatet e dorëzimit përfshihet dhe koha 1 javore për komentet e klientit për secilën fazë.

Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Të gjitha dokumentat e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal nga të gjithë projektuesit.

Materialet dorëzohen në 5 kopje format hard copy (të printuar) dhe 5 cd (4 cd në format soft copy cad,exel,ëord etj, dhe 1 cd në format pdf)

Gjithashtu do dorëzohet versioni i dixhitalizuar i cili transferohet në GIS.

9. Investimi Themelor

Investimi themelor do të dalë nga varianti më i mirë i miratuar nga Këshilli Teknik i Bashkisë së

Tiranës.

10. Sqarime të fundit

Projektuesi është përgjegjës të sigurojë saktësinë dhe pajtueshmërinë me të gjitha standardet dhe normat përkatëse.

Të dhënat e nevojshme për projektim, sikurse janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, vendosja e kontenerëve, planin rregullues të zonës, etj, do të merren nga projektuesi sipas formularëve përkatës.

Ortofoto e objektit

